

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"HABILI CONSTRUCTION" SH.P.K

Në mbështetje të Nenit 230, parografi 2 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Nenit 28, parografi 3 i Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, sot më datë 04.03.2021, Ortaku i Vetëm:

-**Z. Gazmend Habili**, shtetas shqiptar, lindur më 11.03.1974, në Kavajë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H40311061K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotëruesh të 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.


NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**Habili Construction**" **sh.p.k.**, në vijim referuar si "*Shoqëria*".

NENI 2
BAZA LIGJORE

- 2.1** *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2** Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3
SELIA



- 3.1** Selia kryesore e aktivitetit të Shoqërisë është në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2** Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 4 OBJEKTI

- 4.1** Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë përfshin sa më poshtë vijon:

- *Aktivitet në fushën e ndërtimit me fondet e veta ose publike të objekteve të ndryshme industriale dhe civile të çdo lloji, për vete apo për të tretë, private dhe/ose publike, si dhe restaurimi apo riparimi i tyre, marrja e të drejtave dhe çdo lloj avantazhi në çdo lloj forme ligjore që është e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, si dhe shfrytëzimi i të gjitha sipërmarrjeve që kanë të bëjnë me veprimitarinë e mësipërme, në kufijtë e lejuar nga ligji;*
- *Kryerja e shërbimeve të projektimit, zbatimit, montimit, supervizimit, kolaudimit për punime ndërtimi dhe infrastrukturë;*
- *Projekte të të gjitha llojeve në ndërtim, infrastrukturë, hidroenergjistik, veprat arti dhe arkitekturë. Ndërtim rrugësh të të gjitha kategorive, autostrada, mbikalime, veprat hidrike, veprat arti, të urave, ujësjellësave, kanalizimeve, gërmimeve të dheut, hapje rrugësh, hapje kanalesh, etj., me makineri dhe pajisje të ndryshme;*
- *Shoqëria mund të ushtrojë veprimitari në fushën e turizmit, duke investuar me fondet e veta ose jo në këtë fushë për krijimin e qendrave, pikave dhe fshatrave turistikë, si dhe të mundësojë infrastrukturën e tyre brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;*
- *Restaurimi, riparimi dhe tregtimi i të gjitha objekteve civile-industriale-turistike;*
- *Aktivitet në fushën e shërbimeve elektro-mekanike, inxhinierike në makineri dhe pajisje të ndryshme, në veprat civile, montime dhe çmontime teknike, kullash metalike të tensionit, punime, montime, impiante të prodhimit të energjisë elektrike dhe shpërndarjes së saj, konstruksione të ndryshme;*
- *Zhvillim zonash me qëllime rezidenciale dhe tregtare, shitje-blerje e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Ushtrimi i çdo lloj operacioni dhe transaksiioni në lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin, tregtimin, shitjen, shpërndarjen e pajisjeve dhe materialeve të ndryshme elektrike,*

elektro-mekanike, materiale ndërtimi, plastike apo materiale të tjera në fushën e ndërtimit dhe shërbimeve elektro-mekanike, si me shumicë dhe pakicë, në formën e lëndës së parë, gjysmë të gatshme, makineri dhe pajisje, teknologji, etj.;

- *Kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm në funksion të veprimtarisë së saj.*

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 5.1** Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- 6.1** Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2** Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- 6.3** Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

-Z. Gazmend Habili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1** Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1** Emërohet si Administrator i Shoqërisë **Z. Gazmend Habili**, shtetas shqiptar, lindur më 11.03.1974, në Kavajë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H40311061K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.



- 8.2** Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe dispozitave të Statutit të shoqërisë.
- 8.3** Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjera.
- 8.4** Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.


NENI 9
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1** Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2** Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje originale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKU SHOQËRISË

"HABILI CONSTRUCTION" SHPK

GAZMEND HABILI


Gazmend Habil